



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail: contact@pallatirinise.com

www.pallatirinise.com

Dt: 07.04.2026

Në bazë të dispozitave të nenit 7 të Rregullores me nr 1/333 të datës 24.02.2026 për Procedurën e Dhënies me Qira të Hapësirave, dhe pas identifikimit nga Zyra për Marrëdhënie me Klient, Marketing dhe Promocion për hapësirat e lira sipas nenit 12, dhe bazuar në vendimin e datës **07.04.2026** Kryeshefi Ekzekutiv, **Shpend Bilalli** N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me seli në Prishtinë, me datën **07.04.2026**, mori këtë:

FTESË PËR OFERTË

N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A. fton të gjitha subjektet e interesuara:

- Personat juridik (për ushtrim të veprimtarisë – afarizëm),
 - Personat fizik dhe juridik (për depo),
- të aplikojnë për marrjen me qira të hapësirave për një periudhë të caktuar.
Hapësirat e destinuar për persona juridik – hapësira afariste:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi për m ²
1.	Lok. Nr. 32,33 / QT16 (ish ANNOA)	34.71 m ²	18.92€ Neto
2.	Lok. Nr. 31 / QT9 (Rialko lirohet me 01.05.2026)	92.06 m ²	18.92€ Neto
3	Lok. Nr. 41 / QT22 (Moda Men lirohet me 01.05.2026)	254.59 m ²	18.92€ Neto
4.	Lok. Nr. 068 / QT34 (ish life style)	101.83 m ²	11.87 € Neto
5.	Zyrja Nr 116/2 / SU097-1 përballë sallës së vogël (DIGJIT – ALB)	34.71 m ²	5.99€ Neto
6.	Zyre Nr 05,06,07,09 / PR59 (Game Plus lirohen 16.05.2026) perballe Rilinjes rr.kryesore	134.79 m ²	10.89€ Neto
7.	Zyre nr. 06 / SU006 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	12.28m ²	10.89 € Neto
8.	Zyre nr. 07 / SU007 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	12.18 m ²	10.89 € Neto
9.	Zyre nr. 08 / SU008 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	11.96 m ²	10.89 € Neto
	DEPOT E SPORTIT		
10.	Depo nr. SU081 (përball trim kabinetit në korridorin e Sallës së Vogël të Sportit DEPO NEN SHKALL)	112.5 m ²	3.58 € Neto
11.	Depo nr. SU076 (ish Sigurimit në korridoret e Sallës së Vogël të Sportit)	27.58 m ²	3.58 € Neto

Vërejtje:

Për hapësirat sportive, mund të aplikojnë vetëm federatat dhe klubet sportive, pasi ato janë të destinuara për veprimtari sportive.

Afati i kontratës:

Një (1) vit nga data e lidhjes së kontratës.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. Formulari i aplikimit i cili mund të shkarkohet përmes ueb faqes/emailit zyrtar,
2. Kopje e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal me të dhëna përkatëse;
3. Kopje e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të biznesit;
4. Oferta financiare – çmimi për m² (pa TVSH);
5. Vërtetim nga ATK-ja që dëshmon se biznesi është aktiv;
6. Të dhënat e arkës fiskale;
7. Dëshminë e pageses për aplikim në vlerë prej 300 euro e cila paguhet në xhironlogaritë e Pallatit,

Kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm:

1. Çmimi më i lartë se sa çmimi fillestar i shpallur për m²;
2. Tarifa e aplikimit është 300,00 €, e cila paguhet në xhironlogari;
3. **17-08-0206-000-000-56 (NLB)**
4. **20-33-0002-180-440-76 (TEB)**
5. **2415-1306-0000-2579 (PriBank)**

Tarifa kompensohet me faturën e parë të qirasë.

- Nëse ofertuesi i përzgjedhur tërhiqet nga kontrata, tarifa nuk i kthehet.
- Ofertuesve të pazgjedhur, tarifa u kthehet.

Ofertat nuk do të merren parasysh në rastet kur:

1. Ofertuesi ka qenë qiramarrës i papërgjegjshëm më parë;
2. Oferta nuk përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Oferta arrin pas datës dhe orës së përcaktuar.

Afati i dorëzimit të ofertave:

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur më datë **17.04.2026, deri në ora 12:00** në Zyrën e Arkivës – N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet:

- Emri i ofertuesit
- Numri i hapësirës
- E-maili zyrtar
- Numri i telefonit

Hapja e ofertave:

Ofertat do të hapen nga Komisioni për Vlerësim në prani të ofertuesve,

10 minuta pas përfundimit të afatit të dorëzimit – pra më **17.04.2026, deri në ora 12:10**, në zyret e Drejtorisë së N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Vizitat në hapësira:

Të gjithë të interesuarit mund t'i vizitojnë hapësirat nga **07.04.2026 deri më 17.04.2026 në ora 10:00**,

çdo ditë pune, nga ora 10:00 – 15:00,

duke u lajmëruar te Recepcioni i N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Kërkesa / Aplikacioni mund të merret:

- Në e-mail: contact@pallatirinise.com
- Në uebfaqen zyrtare: www.pallatirinise.com
- Fizikisht në Recepcionin e N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Për më shumë informata, jeni të mirëpritur të kontaktoni me zyrën përkatëse.